

VENDIM
Nr. 39/2025

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT PANO XHIXHO ANËTAR TË KËSHILLIT
DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93 dhe 94, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 55 dhe 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pano Xhixho zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për një mandat 5-vjeçar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miratuar në datën 17.3.2025.